



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.20/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 15.10.2024 të parashtruar nga avokatja Z. L. nga Gjilani, për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve të Divizionit Civil të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Gjilan, më datë 28.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET ankesa e parashtruar nga avokatja Z. L. nga Gjilani, e datës 15.10.2024, për inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve të Divizionit Civil të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Gjilan, konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Av. Z. L. më datë 15.10.2024 i është drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) – Njesisë për Inspektim Gjyqësor me një ankesë, ndërsa KGJK, përkatësisht Njësia për Inspektim Gjyqësor më datë 22.10.2024 këtë ankesë i ka dërguar Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan si autoritet kompetent për ta trajtuar të njëjtën.

Në ankesë, e njëjta thekson se ka dorëzuar gjithsej 102 padi në Gjykatën Themelore në Gjilan, por të njëjtat trajtohen ndryshe varësisht se te cili gjyqtar bie lënda, ashtu që disa lëndë janë kthyer për plotësim, e disa të tjera janë dërguar për përgjigje në padi. Ka konsideruar se kthimi i padisë së plotësuar është i pamundur për shkak se vlera e kontestit nuk mund të përcaktohet pa ekspertizë gjyqësore, e për këtë rrethanë ka marrë shembuj vendime të Gjykatës Themelore në Prishtinë e në Gjakovë. Për këtë rrethanë ka theksuar se është takuar me kryetarin e gjykatës, duke ia prezantuar dy aktvendime të ndryshme për lëndën e njëjtë – njëra që është kthyer në plotësim dhe tjetra që është dërguar për përgjigje në padi, duke llogaritur gjithsej 55 aktvendime të dërguara për përgjigje në padi e 5 për plotësim. Ka vlerësuar se pas takimit, kryetari i gjykatës ka ndikuar të gjyqtarët që të kthehen në plotësim paditë. Lidhur me lëndë të pensionerave, KEDS dhe të policisë (në rastin konkret avokatja është përfaqësuese e zyrtarëve policor) ka shtuar se kryetari i gjykatës ka caktuar disa bashkëpunëtor profesional që merren vetëm me

këtë lëndë dhe të njëjtit i kthejnë në plotësim pa i lexuar fare paditë, edhe atë në formë shabllonike dhe të kundërligjshme, e me shumë gabime drejtshkrimore, ndërsa lëndët fizikisht nuk gjenden te gjyqtarët. Lidhur me gjyqtarin B. S. ka theksuar se dy fëmijët e tij, A. S. dhe V. K. janë avokat të licencuar në OAK, ndërsa fëmija tjetër është A. S. – zyrtar i IT në entin e pensionerave dhe ka vlerësuar se i njëjti kundërligjshëm i ka siguruar vërtetime këtyre dy avokatëve dhe avokateve K. A. dhe A. Sh., të cilat janë në shoqëri me ta. Prej momentit që fëmijët e gjyqtarit kanë dorëzuar paditë në gjykatë, ka filluar prapë të aplikohet taksa për dorëzim, ndërsa nuk ka një sqarim se kur jemi liruar nga taksa, kur jemi detyruar të paguajmë, me çfarë dokumenti apo udhëzimi.

Pretendimeve për shkelje disiplinore i ka bashkëngjitur: vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore, C.nr.4419/24 të datës 19.09.2024; aktvendim për plotësim të padisë C.nr.4923/24 të datës 23.08.2024; Precizimin e padisë C.nr.4923/24; Aktvendimin për përgjigje në padi C.nr.5016/24 dhe padinë sipas kësaj çështje.

Pas shqyrtimit të ankesës, bazuar në nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, autoriteti kompetent konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar dhe nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore.

Pretendimet e ankueses nuk konsistojnë në shkeljet disiplinore të parapara me këtë ligj, edhe atë:

- Sa i përket takimit të realizuar me kryetarin e gjykatës, në të njëjtin takim avokatja ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me faktin se disa lëndë të njëjta dhe me përmbajtje të njëjtë po trajtohen ndryshe, ashtu që disa prej tyre kthehen në plotësim, e disa dorëzohen për përgjigje në padi. E njëjta ka sjellur dy aktvendime për t'i krahasuar: C.nr.4840/24 që është kthyer në plotësim dhe C.nr.5016/24 që është dorëzuar për përgjigje në padi. Kryetari i gjykatës pas shqyrtimit të aktvendimeve ka konstatuar se avokatja në padinë C.nr.4840/24 nuk ka pasur shumë të përcaktuar për njërin kompensim të kërkuar dhe për këtë arsye është kthyer në plotësim, ndërsa në padinë C.nr.5016/24 e njëjta ka pasur shumë të përcaktuar dhe për këtë arsye i është dërguar aktvendimi për përgjigje në padi të paditurës. Nga kjo, kryetari i gjykatës nuk ka vërejtur ndonjë rrethanë shqetësuese se trajtimi i lëndëve po bëhet në mënyrë të pabarabartë apo diskriminuese.

- Sa i përket mënyrës së vendosjes, se a i kthejnë gjyqtarët paditë në plotësim, apo i dërgojnë për përgjigje në padi, kjo kompetencë është diskrecion i gjyqtarëve në vendosje dhe nuk mund të paraqes shkak për përgjegjësi disiplinore, pasi shqyrtimi paraprak i padisë konsiston pikërisht në këtë rrethanë që të vlerësohet se a duhet kthyer padia në plotësim apo i plotëson të gjitha kushtet ligjore për dërgim në përgjigje në padi. Ndërsa, siç u konstatua më lartë, e njëjta avokate në disa padi ka të precizuar shumë, e në disa të tjera nuk ka të precizuar shumë (fjala është për njërin lloj të kompensimit). Për më tepër, nga 102 paditë e dorëzuara, sipas evidencës së lëndëve në gjykatë nuk konstatohet t'i jetë hedhur ndonjë padi për shkak se nuk e ka plotësuar, andaj deri në këtë fazë të procedurës, sa i përket lëndëve të avokates në fjalë, e njëjta nuk ka pasur ndonjë pasojë ligjore.

- Sa i përket mënyrës së organizimit të lëndëve në gjykatë, se a gjenden lëndët fizikisht në zyrë të gjyqtarëve apo bashkëpunëtorëve profesional, apo se a merren disa bashkëpunëtor profesional me një lloj

të caktuar të lëndëve, kryetari i gjykatës vlerëson se nuk është kompetencë e avokates të vlerësojë mënyrën e organizimit nga ana e menaxhmentit të gjykatës.

- Sa i përket gabimeve drejtshkimore, apo kundërligjshmërisë së vendimeve procedurale, kryetari i gjykatës vlerëson se avokatja ka të drejtë të ushtrojë të drejtat e garantuara me kushtetutë e ligj, siç janë kërkesat për korrigjime që mund të ushtrohen në çdo kohë dhe mjetet e rregullta e të jashtëzakonshme juridike saherë që vlerëson se një vendim është në kundërshtim me ligjin. Për këtë arsye diferencohet shkallshmëria e vendimeve deri në instancën e tretë me veprimet që përbëjnë shkelje disiplinore, në të kundërtën sipas avokates çdo vendim që nuk është në përputhje me ligjin do të përbënte shkelje disiplinore.

- Edhe sa i përket pretendimit lidhur me gjyqtarin B. S. dhe se fëmijët e tij kanë siguruar vërtetime për pensionerët në mënyrë të palejuar, kryetari i gjykatës vlerëson se nuk ka kompetencë për të vlerësuar rrethana jashtëgjyqësore e që nuk kanë të bëjnë me sjelljen e gjyqtarit apo ndonjë shkelje tjetër të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë dhe Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

- Sa i përket taksave për padi, neni 253, paragrafi 1, pika d) dhe paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Kontestimore ka paraparë në mënyrë decidive që çdo padi duhet të përmbajë vlerën e kontestit dhe të paguhet taksën gjyqësore, ndërsa në nenin 12.1 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore është përcaktuar shuma se sa duhet të paguhet taksa, çka mund të vijmë në përfundim që edhe po të ketë padia vlerën e kontestit prej 0.00 euro, duhet të paguhet shuma prej 20.00 euro si taksë gjyqësore. Ndërsa, avokatja në fjalë dhe disa avokatë të tjerë në disa prej lëndëve të dorëzuara nuk e kanë bërë një gjë të tillë, prandaj padyshim se paditë janë kthyer në plotësim.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e avokates Z. L. nga Gjilani, e datës 15.10.2024, është e palejuar dhe për të njëjtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryetari i Gjykatës,
Venhar Salihu**

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtrueses së ankesës,
2. KGJK-së
3. Dosjës së lëndës.